

ALVIN SARAÇI

**MARRËDHËNIET TREGTARE TË SHQIPËRISË
ME VENECIAN NËPËRMJET PORTIT TË DURRËSIT
NË KAPËRCYELL TË SHEKUJVE XVII - XVIII**

Abstrakt:

Marrëdhëniet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Venecies në shekujt XVII-XVIII janë objekt studimi i historisë ekonomike për faktin se me anë të statistikave kuantitative të tre mallrave kryesorë: dyllit, lëkurëve dhe leshit, mund të përcaktohet fluksi i tregtisë që kalonte nga porti i Durrësit drejt Venecies. Në gjysmën e dytë të shek. XVII, rritja ekonomike e Shqipërisë ishte e qëndrueshme dhe në ngjitje në dekadën e parë të shek. XVIII. Duke parë se marrëdhëniet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Venecies ishin në kulmin e tyre, kjo e fundit vendosi më 1671 hapjen e konsullatës së saj në Durrës. Durrësi u kthye në portin tranzit më të rëndësishëm në Adriatik për marrëdhëniet tregtare me Venecien pas rënies në dekadencë të portit të Splitit më 1674. Kështu në periudhën 1684-7, tregtia ndërmjet Durrësit dhe Venecies u rrit nga 6 000 në 9 500 dengje (colli) dhe në trevjeçarin 1700 - 1703, numri i tyre pati një rritje të mëtejshme nga 10 000 në 17 000 dengje, për të patur një zbritje të lehtë në vitin 1704 me 14500 dengje dhe të mëtejshme në vitin 1705 me 9 500 dengje, ndërkohë që në vitin 1706 u regjistruan vetëm 8 000 dengje.

Fjalë kyçe:

Tregtia, Venecia, Shqipëria, Durrësi, shekujt XVII-XVIII, konsullata veneciane e Durrësit

Studimi i marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë me Venecian në shek. XVIII përbën një temë me interes të veçantë për historinë ekonomike, pavarësisht faktit se nuk ka qenë sa duhet në qendër të vëmendjes nga historiografia shqiptare dhe e huaj, ajo është pjesë e mozaikut të tregtisë

ndërkombëtare.¹ Këto shkëmbime na japin mundësi që të krijojmë statistika mbi fluktuacionin e fluksit të mallrave që kalonin në portin e Durrësit dhe në portet e tjera të Shqipërisë në shek. XVII dhe XVIII, duke u bazuar mbi shifra të shpërndara në dokumentet e autoritetit venecian për tregtinë të Arkivave Shtetërore të Venecias që përfshijnë edhe konsullatën veneciane të Durrësit.*

Në gjysmën e parë të shek. XVIII, mosmbajtja e rregullt e shifrave të tregtisë e bën më të vështirë studimin. Për disa nga vitet ekzistojnë shifrat e përgjithshme të tregtisë të gjetura rastësisht mes dokumenteve që nuk i përkasin Durrësit. Gjithashtu, na kanë ardhur në ndihmë edhe policat e ngarkesave të anijeve të veçanta tregtare sipas viteve megjithëse në disa raste ato janë të paplota. Po ashtu ndihmesë kanë qenë edhe letërkëmbimet e relacionet e konsujve të Venecias në Durrës, që na japin një panoramë të shkëmbimeve tregtare. Ndërsa periudha e gjysmës së dytë të shek. XVIII, ku janë fokusuar disa nga autorët, përkon me rregullat që u vendosën nga Pesë të Urtët për Tregtinë dhe plotësimin më të saktë përsa i përket shifrave të tregtisë në regjistrat doganorë pas vitit 1770.

Periudha 1671-1720 përmbledh hapjen e konsullatës veneciane të Durrësit, lulëzimin e tregtisë me Venecian, që vazhdoi të ishte në kulmin e saj edhe gjatë dy dekadave të para të shek. XVIII dhe më pas shkoi drejt rënies, megjithëse aktiviteti i saj do të shtrihej deri në fundin e shek. XVIII. Shkaqet për këtë duhen kërkuar në largimin e tregtarëve të Voskopojës nga porti i Durrësit drejt Danubit dhe Europës Qendrore kryesisht në Austri e Hungari për marrëdhëniet tregtare me vende të tjera dhe në rëndësinë gjithnjë e më të madhe të Shkodrës si udhëkryq i tregtisë me Venecian deri në zëvendësimin e rolit të mëparshëm që luante Durrësi.²

Në gjysmën e dytë të shek. XVII, dinamika e ekonomisë shqiptare njohu një ngritje, që do të ishte e qëndrueshme edhe në dekadën e parë të

¹ Sergio Anselmi, "Venezia e i Balcani: La "Scala" di Spalato tra Cinque e Seicento", në *Studi Storici*, anno 13, nr. 2, Roma: Carocci editore, prill-qershor 1972, f. 408-412.

* Studimi bazohet mbi fondin arkivor të Pesë të Urtëve për Tregtinë. (Cinque Savi alla Mercanzia)

² Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës (1669 -1769)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena; 2010, f. 112; Alvin Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës me Venecien në shekujt XVII dhe XVIII*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, f. 262.

shek. XVIII, ndërkohë që ekonomia e Venecias ishte në një periudhë dekadence relative që u reflektua në tregti dhe lundrim, sepse qendra e gravitetit të tregtisë ndërkombëtare u spostua drejt fuqive të Atlantikut (Anglisë, Francës dhe Holandës). Edhe Perandoria Osmane ishte gjithashtu në rënie.³ Pikërisht, parë nga ky këndvështrim, ekonomia shqiptare përbën një nënsistem ekonomik.⁴

Duke marrë parasysh pozitën e përshtatshme gjeografike të Shqipërisë në Mesdheun Lindor si ndërmjetësuese me hinterlandin ballkanik dhe resurset ekonomike të domosdoshme për industrinë, disa shtete europiane u interesuan për hapjen e konsullatave të tyre në Shqipëri që në vitin 1640. Madje, supozohet që Franca ta ketë hapur atë në këtë periudhë, megjithëse nuk kemi të dhëna për një gjë të tillë.⁵ Kjo përkon me periudhën kur tregtia franceze dhe porti i Marsejës arritën kulmin.⁶

Për marrëdhëniet tregtare ndërmjet Ballkanit, Perandorisë Osmane dhe Venecias, vendkalimi i vetëm ishte porti transit i Splitit (*la scala di Spalato*), i hapur më 1592.⁷ Me fillimin e luftës së Kretës (1646-1669) tregtia nëpërmjet portit të Splitit u reduktua me 60%, duke i dhënë shkas daljes në skenë të porteve shqiptare, të cilat u kthyen në udhëkryq të shkëmbimeve tregtare dhe e gjallëruan tregtinë me Venecian.⁸ Në të

³ Omer Lutfi Barkan, “Le déclin de Venise dans ses rapports avec la décadence économique de l’Empire Ottoman”, në *Aspetti e cause della decadenza economica veneziana nel secolo XVII, Civiltà veneziana*, vol. 9, Centro di cultura e civiltà, Venezia, Roma: 1961, f. 275-7; Massimo Costantini, “Commercio e Marina”, në *Storia di Venezia: L’ultima fase della Serenissima*, vol. 8, ed. Piero Del Negro, Paolo Preto, Istituto dell’Enciclopedia Italiana “Giovanni Treccani”, Roma: 1998, f. 555; Ardian Muhaj, “Ekonomia e trojeve shqiptare në shekujt XVI-XVIII. Zhvillimi i qëndrueshëm i një ekonomie rajonale në mesin e dy botëve në ngritje e rënie: Venedikut dhe Perandorisë Osmane”, në *Paraja dhe bankingu në Shqipëri nga Antikitëti në ditët tona*, Punimet e Konferencës së Parë të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, Tiranë, 14-15 qershor 2017, Tiranë: Idea Shpk, 2017, f. 83.

⁴ A. Muhaj, “Ekonomia e trojeve shqiptare në shekujt XVI-XVIII...”, f. 87.

⁵ François Charles Hugues Laurent Poqueville, *Voyage de la Grece*, vol. 2, Paris: Firmin Didot, 1826, f. 420.

⁶ Michel Morineau, “Flottes de commerce et trafics français en Méditerranée au XVII^e siècle (jusqu’en 1669)”, në *XVII^e Siècle*, nr. 86-87, Paris: 1970, f. 156-7.

⁷ Renzo Paci, “La «Scala» di Spalato e la politica veneziana in Adriatico”, në *Quaderni storici delle Marche*, Anno V, nr. 13, Ancona: il Mulino S.p.a., 1970, f. 66.

⁸ Cristian Luca, “L’Importazioni delle merci levantine nella Venezia del Seicento e del primo Settecento: la cera e i

njëjtën kohë, doli në pah edhe Gryka e Kotorrit (Boka Kotorska), që ishte jo vetëm një rrugë tjetër për kalimin e mallrave drejt Venecias, por kishte një sërë portesh me lundrim të zhvilluar. Në një relacion të Proveditorit të Përgjithshëm të Dalmacisë, Alvise Mocenigo në vitin 1639, ai u propozonte autoriteteve veneciane që ta kthenin atë në një pol tregtar (*la scala di Cattaro*), që përveçse vendkalim për karvanët me mallra kryesisht nga Shkodra, Tivari dhe Elbasani drejt Venecias, që ekuilibronin tregtinë e Raguzës, të përdorëshin për transportin e mallrave anijet e portit kotorras të Perastit dhe nga ana shqiptare anijet e lundrimit të Ulqinit.⁹

Nga mesi i shek. XVII, një sërë portesh ku përfshiheshin Marseja, Livorno dhe Ankona, u kthyen në porte të lira që rivalizonin tregtinë veneciane, duke i detyruar autoritetet veneciane që edhe për Venecian të ndiqej rruga e portit të lirë për mallrat e eksportit pa taksa gjatë periudhës njëzetvjeçare 1662-1682, por kjo krijoi mungesë të ardhurash doganore.¹⁰

Nënshkrimi i paqes në maj 1670 ndërmjet Venecias dhe Perandorisë Osmane e rihapi tregtinë.¹¹ Megjithatë, humbja e ishullit të Kretës, zotërimit të fundit venecian në Mesdhe, do të thoshte për Venecian një tërheqje drejt një tregtie rajonale në Adriatik.¹² Impakti negativ mbi ekonominë veneciane dhe kostoja e lartë që pati lufta e gjatë e Kretës, e cila i konsumoi financat veneciane, u reflektua në rritjen e taksave dhe përpjekjet e Venecias për të dalë nga stanjacioni.

Në dekadat e para të shek. XVII, tregtarët shqiptarë në Venecie ishin organizuar në një komunitet, që përbënte një terren të favorshëm për

pellami provenienti dai Principati Romeni”, në *L'Italia e l'Europa Centro Orientale attraverso i secoli. Miscellanea*

di studi di storia, ed. Cristian Luca, Gianluca Masi, Andrea Piccardi, Brăila, Museo di Brăila, Istituto romeno di cultura e ricerca umanistica di Venezia, Istros: 2004, f. 325.

⁹ R. Paci, “La «Scala» di Spalato...”, f. 96.

¹⁰ Massimo Costantini, “La regolazione dei dazi marittimi e l’esperienza del porto franco a Venezia tra il 1662 e il 1684”, në *La finanza pubblica in età di crisi*, ed. Antonio di Vittorio, Bari: Cacucci, 1993, f. 77-88.

¹¹ Riccardo Predelli (ed.), *I Libri Commemorativi della Repubblica di Venezia, Regesti*, vol. 8, Venezia: Regia Deputazione Veneta di Storia Patria, Stabilimento geografico Federico Visentini, 1914, XXIX, dok. nr. 59, maj 1670, f. 32.

¹² Luciano Pezzolo, “L’Economia”, në *Storia di Venezia dalle origini alla caduta della Serenissima: La Venezia barocca*, vol. 7, ed. Gino Benzoni e Gaetano Cozzi, Istituto dell’Enciclopedia Italiana “G. Treccani”, Roma: 1997, f. 369-433.

shkëmbimet tregtare.¹³ Madje, në vitin 1670, disa tregtarë iu drejtuan autoritetit venecian të Pesë të Urtëve për t'i kërkuar hartimin e rregullave të reja për tregtinë. Megjithatë, për hapjen e rrugës tregtare me Shqipërinë duhet të ketë qenë përcaktuese përtej ndikimit të diasporës shqiptare, periudha e begatë që po kalonte tregtia në portet shqiptare ku kryqëzoheshin rrugët tregtare me tregjet shqiptare dhe ballkanike, me rëndësi parësore për sigurimin e lëndëve të para cilësore për industrinë veneciane dhe shpërndarjen e prodhimeve të manifakturës veneciane.

Konsullata veneciane në Durrës u hap më 1671 dhe do të drejtonte marrëdhëniet tregtare me portet shqiptare nga Tivari (Bar) në Malin e Zi deri në Sajadhë (Saiada) në Greqi duke përfshirë edhe Shirgjjin, portin në lumin Bunë të Shkodrës, Shëngjinit dhe Vlorën.¹⁴

Në këtë mënyrë, Durrësi u zgjodh nga venecianët si një vendkalim i dytë në Ballkan për kalimin e fluksit të mallrave drejt Venecias pas portit transit të Splitit, aktiviteti i të cilit sipas të dhënave statistikore vazhdon deri në vitin 1674.¹⁵ Pas kësaj date, Durrësi do të zinte vendin e Splitit, si porti më i rëndësishëm për marrëdhëniet tregtare me Venecian në Adriatik. Ishin disa faktorë që ndikuan në këtë drejtim: së pari, rënia në dekadencë e portit të Splitit; së dyti, Durrësi ishte një port i rëndësishëm ndërkombëtar, megjithëse nuk ishte një qytet me një zhvillim të madh urban për sa i përket demografisë.¹⁶ Në vitin 1641, sipas relacionit të Mark Skurës, ipeshkvit katolik të Durrësit, qyteti numëronte 300 shtëpi brenda mureve dhe 2000 shtëpi me gjithë provincën përreth.¹⁷

¹³ Maria Pia Pedani, "The culture of trust. Ottoman merchants and Venetian Notaries in the Early Modern Period", në *Venetians and Ottomans in the Early Modern Age, Essays on Economic and Social Connected History*, ed. Anna Valerio, *Hilâl. Studi turchi e ottomani*, 6, ed. Maria Pia Pedani, Elisabetta Ragagnin, Venezia: Ca'Foscari, 2018, f. 40.

¹⁴ *Archivio dello Stato di Venezia* (më tej: Asv), Cinque Savi alla Mercanzia (më tej: CSM), 2° Serie (më tej: S), busta (më tej: b.) 27/bis, pjesa e parë, 13 korrik 1671. Pikërisht më 13 korrik 1671, u zgjodh nga Pesë të Urtët konsulli i parë i Venecies në Durrës Stefano de Campis.

¹⁵ R. Paci, "La scala di Spalato...", f. 66, 105.

¹⁶ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: letra të konsujve venedikas të Durrësit (1696-1707)*, përgatiti për botim Zija Shkodra, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1975, "Hyrje", f. 9.

¹⁷ "III Visitationsbericht Marco Scura, Erzbischof von Durazzo, 1641" në *Albania Sacra: Geistliche Visitationsbericht aus Albanien. 2: Erzdiözese Durazzo*, përgatiti për botim Peter Bartl, Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2011, f. 112.

Durrësi ishte në qendër të Shqipërisë, asokohe porti kryesor i saj, seli ipeshkvnore dhe pjesë e Adriatikut që venecianët e kishin pagëzuar si “Gjiri i Venecias”.¹⁸ Megjithëse pjesa shqiptare e Adriatikut nuk kontrollohej nga Venecia, marrëdhëniet e ngushta tregtare mes dy brigjeve do të kontribuonin që Shqipëria të përfshihej në ekonominë veneciane¹⁹. Falë distancës së afërt, autoritetet veneciane për tregtinë e menduan Durrësin si port ideal për transportin e mallrave në një kohë të shkurtër drejt Venecias. Rëndësia e Durrësit u rrit në vitin 1676 për shkak të mbylljes së konsullatave veneciane në Egjipt, Qipro dhe Siri në Mesdheun Lindor të cilësuar si jofitimprurëse.²⁰

Por ajo që pati më shumë peshë në zgjedhjen e Durrësit ishte se qyteti ishte pikënisja e Rrugës antike Egnatia, e cila kalonte në një sërë qendrash ekonomike të hinterlandit, një pjesë prej të cilave shqipfolëse dhe më pas vazhdonte në drejtim të Selanikut dhe Stambollit²¹. Durrësi ishte destinacion i mallrave dhe tregtarëve, meqenëse shtresa zejtarotregtare e qytetit nuk ishte e zhvilluar si në qytetet e tjera. Me anë të rrugës bregdetare, Durrësi lidhej me Shkodrën në veri dhe Vlorën në jug, ndërkohë që kishte pranë Tiranën, Kavajën dhe Krujën si pjesë të Shqipërisë së Mesme. Durrësi ishte një urë lidhëse me Venecian nëpërmjet Rrugës Egnatia me Elbasanin, kryeqendra e sanxhakut, Voskopojën, pol i rëndësishëm tregtar ku ndërthurej elementi tregtar shqiptar me atë vllaho-arumun, i cili ishte i pranishëm edhe në Kostur e Siatista, si dhe Strugën dhe Ohrin, ku kryqëzoheshin rrugët tregtare me Shkupin dhe Manastirin.²² Pjesa më e madhe e mallrave të Janinës kalonte drejt Korfuzit për në Venecia nëpërmjet portit të Sajadhës që asokohe ishte nën juridiksionin e konsullatës veneciane të Durrësit. Në Durrës arrinte një pjesë e tregtisë së Janinës, Selanikut, Principatave

¹⁸ Suraiya Faroqhi, Donald Quataert, Bruce McGowan, Şevket Pamuk, *An Economic and Social History of the Ottoman Empire, 1600-1914*, vol. 2, Cambridge: Cambridge University Press, 1994, f. 763.

¹⁹ Bruno Caizzi, *Industria e commercio della Repubblica veneta nel XVIII secolo*, Banca Commerciale Italiana, Milano: 1965, f. 258.

²⁰ Vera Costantini, *Il Sultano e l'isola contesa. Cipro tra eredità veneziana e potere ottomano*, Torino: UTET Libreria, 2009, f. 304; Guglielmo Berchet, *Relazioni dei consoli veneti nella Siria*, Torino: Tipografia di G. B. Paravia e comp., 1866, f. 19-20.

²¹ Bukurosh Reçi, *Via Egnatia: Albania: itinerar historik, kulturor, turistik nga perëndimi në lindje*, Tiranë: Morava, 2019.

²² Peter Bartl, *Shqiptarët nga Mesjeta deri në ditët tona*, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, Tiranë: 2008, f. 90-1.

Rumune dhe Moldave, të cilat drejtoheshin nga banë shqiptarë, që tregtonin edhe me anë të portit të Durrësit dhe nga Arvanitochori, ngulim shqiptar në Bullgari dhe anë të tjera të Ballkanit. Në këtë mënyrë, porti i Durrësit ishte gjithashtu një vendkalim për një pjesë të tregtisë së dyllit dhe lëkurëve që kalonte nga Rumania dhe Moldavia drejt Venecias.²³

Lidhur me tregtinë që kalonte në Shqipëri në relacionin e tij, Vicko (i njohur si Visk ose Vinçenc) Zmajević (1670-1745), ipeshkëv katolik i Tivarit dhe Vizitor Apostolik i Shqipërisë, pikërisht në vitin 1703 i ngarkuar nga papa me origjinë shqiptare Gianfrancesco Albani (Klementi XI) për mbajtjen e Kuvendit të Arbrit, shkruante për Shqipërinë:

“Ka pyje me pemë teje të larta, që vlejnë si lëndë ndërtimi për ushtri të tëra, plot miniera sere (pise), sasi të mëdha vaji dhe gruri sa të furnizojë në mënyrë të mjaftueshme dhe me bollëk provincat me të cilat kufizohet dhe vendet edhe më të largëta. Shërbente si vendkalim për mallra të begatë si: mëndafshi, dylli, leshi, saftjani dhe të ngjashme, që nga Vllahia, Moldavia, Rumania, Bullgaria, Serbia dhe Maqedonia arrijnë në sasi të mëdha në Durrës, Shkodër, Sajadhë dhe pasi ngarkohen me anije kristiane transportohen në Venecie dhe një pjesë në Ankonë.”²⁴

Në fakt, në prag të traktatit të paqes së Karlovcit, Pesë të Urtët vunë re ndër portet e Mesdheut Lindor një ecuri të mirë të tregtisë në portin e Durrësit²⁵. Kjo përkon me një rritje ekonomike dhe as që mund të flitet për dekadencë përgjatë shek. XVIII edhe në Dalmaci dhe në Kotorrin

²³ C. Luca, “L’importazione delle merci levantine...”, f. 329, 338-339.

²⁴ “Notitie universali dello stato di Albania, e dell’operato da Monsignor Vincenzo Zmaievich Arcivescovo di Antivari Visitatore Apostolico dell’Albania”, në *Quellen und Materialien zur Albanischen Geschichte im 17 und 18 Jahrhundert, Albanische Forschungen*, vol. 2. përgatiti për botim Peter Bartl, München: Rudolf Trofenik, 1979. “*Produce boschi d’arbori smisurati nella grandezza, atti per la fabrica d’armate intiere, miniere di pece abbondantissima, ogli e grani in quantità tale, che prouede sufficientemente alla consistenza delle confinanti prouincie, et anche delle più lontani. Somministrava il passo alle ricche merci di seta, cere, lane, cordovano e simili che dalla Valachia, Moldauia, Romania, Bulgaria, Seruia, e Macedonia confluiscono abbondantemente à Durazzo, Scuttari, e Saiada, e caricate sopra vascelli christiani sono trasportate in Venezia, e qualche parte in Ancona.*”

²⁵ A. Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës ...*, f. 14.

venecian, që sipas studiuesit Egidio Ivetić përbën një nga variantet rajonale, gjë që e zgjeron vizionin për historinë e Venecias.²⁶

Traktati i Karlovicit (Sremski Karlovci) më 1699 i dha fund Luftës së Moresë (1684-1699) dhe shënoi hapjen e tregtisë ndërmjet Venecias dhe Perandorisë Osmane. Kështu, me fillimin e shek. XVIII, konsullata veneciane e Durrësit rinisi aktivitetin e saj dhe marrëdhëniet tregtare në portin e Durrësit dhe në portet e tjera shqiptare me Venecian iu rikthyen normalitetit. Venecia mori Morenë, disa porte si Preveza e Vonica dhe Kastelnovon (Herzegnovi) e Risanon pranë Kotorrit venecian si *Acquisto Nuovo* për të kompensuar humbjen e Kretës²⁷. Kjo do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë tregtinë me Shqipërinë, sepse në portin e Kastelnovos, Venecia ndërtoi një lazaret, që do të ishte etapa e parë e kalimit të mallrave nga Shqipëria drejt Venecias pas hapjes së tij, më 16 korrik 1701.²⁸

Mungesa e pranisë veneciane në Durrës në vitet që i paraprinin fundit të shek. XVII, i kishte dhënë mundësi tre konsullatave të huaja: franceze, holandeze dhe raguzane që ta shtrinin tregtinë e tyre në Shqipëri. Kjo edhe me ndihmën e shtetasve venecianë, që kishin mbajtur më parë petkun e ish konsullit, kandidatëve për postin e konsullit ose tregtarëve venecianë në Durrës, të cilët kishin ushtruar tregtinë për llogari të konsullatave të tjera.²⁹

Venecias iu desh të përballonte konkurrencën e tregtisë franceze dhe holandeze dhe për këtë pati sukses. Në dy vitet e para të rihapjes së konsullatës veneciane në Durrës, bilanci tregtar ishte pozitiv për venecianët sepse ata kishin mundur të rimerrnin në dorë tregtinë dhe të dërgonin drejt Venecias një sasi të madhe të mallrave. Kjo del në pah në

²⁶ Egidio Ivetić, "The Peace of Passarowitz in Venice's Balkan Policy", në *The Treaty of Passarowitz*, ed. Charles W. Ingrao, Nikola Samardžić, Jovan Pesalj, West Lafayette, Indiana: Purdue University Press, 2011, f. 64-65. Ivetić pohon: "In short, the history of the late republic should be reconsidered, we should take into account its many variations".

²⁷ Samuele Romanin, *Storia documentata di Venezia*, vol. VII, Venezia: Pietro Naratovich, 1858, f. 485-494.

²⁸ Guido Candiani, "Sanità e controllo mercantile alle Boche di Cattaro: il lazaretto di Castelnovo", në *Mediterranea, Ricerche storiche*, anno XVII, Associazione no profit Mediterranea, Palermo: 2020, f. 36-37; *ASV, CSM*, 1° S, b. 167, nr. 88.

²⁹ Alvin Saraçi, "Roli i konsullatës veneciane të Durrësit në mbrojtje të interesave ekonomike të Venecias në fillim të shek. XVIII", në *Studime historike*, nr. 1-2, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 100.

letrën e 27 prillit 1702 të konsullit venecian të Durrësit, ku ai shkruan se venecianët kishin arritur të fitonin mbi konkurrencën e huaj dhe ta reduktonin taksën konsullore* të konsullatave franceze dhe holandeze nga 2½ realë për deng ose koli në 0.5 realë (e barasvlershme me 60 akçe osmane)³⁰. Nga letërkëmbimi i konsullit venecian me Pesë të Urtët mësojmë se më 1700 edhe për venecianët, taksa konsullore ishte gjithashtu gjysmë reali për koli dhe më 1704 ishte ulur në çerek reali për koli ose me një vlerë të barabartë me rreth 30 akçe³¹. Kjo taksë ishte pjesë e buxhetit të konsullit dhe përdorej për të mbuluar shpenzimet e zakonshme ku bënin pjesë rrogat e personelit konsullor, shërbimi postar etj., ndërsa për shpenzimet e jashtëzakonshme si për shembull pagesat për lëshimin e berateve që e tejkalonin buxhetin konsullor, shpenzimet mbulohehin nga autoritetet veneciane.

Taksa konsullore ishte 0.5% e taksës doganore veneciane të *Cottimo-s*³² prej 2% për të gjitha mallrat e tregtisë së Durrësit me Venecian.³³ Pjesa tjetër prej 1.5% derdhej në arkën e *Cottimo-s* në Venecia. Në vitin 1704, të ardhurat e konsullit ose taksa konsullore ishte 6.296 dukatë në vit.³⁴ Një pjesë e të ardhurave vjetore prej 2000 dukatësh të buxhetit konsullor sigurohej nga taksa e navllimit [qiramarrjes së anijeve] prej 5% të anijeve nga Perasti, që ngarkonin grurë në Durrës, të cilat nuk paguanin taksë doganore sepse pretendonin se kishin privilegje tregtare.³⁵

* *Consolazione* os *econsolare* ishte taksa e buxhetit të konsullatës ose të ardhurat e konsullit, pjesë e taksës doganore që përfshinte dhe taksën e navllimit (qirave të anijeve tregtare) dhe të ankorimit të tyre në portin e Durrësit.

³⁰ ASV, CSM, 1°S., b. 661, 27 prill 1702; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit ...*, dok. nr. 39, 27 prill 1702.

³¹ ASV, CSM, 1°S., b. 661, 31 dhjetor 1700; *po aty*, CSM, 2°S., b. 28, 25 shtator 1704. Kjo shfaqet në një relacion të Pesë të Urtëve drejtuar Doxhës së Venecies Alvise Mocenigo. Duhet patur parasysh se në fillim të shek. XVIII, 1 zekin shkëmbehej me 300 akçe.

³² "Cottimo", në Giulio Rezasco, *Dizionario del linguaggio italiano storico ed amministrativo*, Firenze: Le Monier, 1881, f. 316-318. Rrjedh nga latinishtja *quotūmus* (që do të thotë në ç'sasi) dhe ishte një taksë doganore e vjetër zakonisht prej 2%, e cila varionte sipas ecurisë së tregtisë. U aplikua fillimisht nga konsujt venecianë për mallrat e import-eksportit dhe më pas edhe nga shtete të tjera europiane.

³³ ASV, CSM, 1°S., b. 661, 20 shtator 1706; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, dok. nr. 127, 20 shtator 1706, f. 230-231.

³⁴ *Po aty*, CSM, 2°S., b. 28, pjesa 5, 25 shtator 1704. Kjo shifër shfaqet në një relacion që Pesë të Urtët për Tregtinë i drejtonin Doxhës së Venecies Alvise Mocenigo.

³⁵ *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, dok. nr. 65, 29 korrik 1705, f. 124.

Në vitin 1706, për shkak të buxhetit të vogël konsullor, Pesë të Urtët i rikthyen gjithashtu konsullit venecian të Durrësit Pietro Rosa të drejtën që të tërhiqte taksën e ankorimit prej 12 realësh për anijet e mëdha dhe 9 realë për anijet e vogla, e cila kishte ekzistuar deri dy vjet më parë.³⁶

Taksa doganore e *Cottimo*-s u ishte njohur venecianëve sipas artikullit VII dhe IX të marrëveshjes ndërmjet Venecias dhe Perandorisë Osmane në vitin 1453 dhe përbënte vetëm një pjesë të taksës doganore.³⁷

Sa rëndësi kishte tregtia me Shqipërinë për Venecian, dëshmohet nga fakti se Pesë të Urtët ngritën në Venecie zyrën e *Cottimo*-s së Durrësit, Shkodrës dhe porteve shqiptare në periudhën 1700-1713 dhe caktuan një të deleguar (*deputato*) për të administruar këtë detyrim doganor.³⁸

Cottimo paguhej dhe përcaktohej sipas listës së tarifave për secilin mall si vijon dhe shërbente gjithashtu për mallrat që transportoheshin me anije si pjesë e siguracionit detar për të mbuluar dëmet nga mbytja e anijes, fenomenin e korsarisë etj.³⁹

Tabela 1: *Lista e tarifave doganore në dukatë të mallrave të eksportit të miratuara me dekret të Senatit më 6 gusht 1705*⁴⁰

Malli	Sasia	Tarifa në dukatë më 1705
Lesh	Dengje me 160 libra	4.10
Dyll	Pako / koli me 260 libra	1
Veshje të bardha salonike	Pako / koli me 30 copë	16.25
Mbulesa krevati prej leshi të ashpër	10 copë	9.19
Batanije dalmate (Schiavine)	10 copë	3
Kanavacë e ngjyrosur dhe	Pako / koli me 120 copë	3

³⁶ *Ibidem*.

³⁷ Domenico Gatteschi, *Manuale di diritto pubblico e privato ottomano*, Aleksandri: V. Minasi & Co., 1865, f. 18; Gabriel Bie Ravndal, *The Origin of the Capitulations and of the Consular Institution*, Washington: Government Printing Office, 1921, "Appendix nr. 2, f. 92. Në versionin original të kapitulacionit të parë veneto-osman të vitit 1453 të firmosur nga Sulltan Mehmeti I për ambasadorin venecian në Stamboll ose bailin Bartolomeo Marcello, sanksionohet me ligj edhe taksa doganore e cottimo-s.

³⁸ Venecia kishte krijuar tre proveditorate vetëm për Cottimo-n e Londrës, Aleksandrisë dhe Damaskut, që mbështesnin konsullatat e këtyre vendeve deri në fund të shek. XVII.

³⁹ Georg Crist, *Trading conflicts: Venetian Merchants and Mamluk Officials in Late Medieval Alexandria*, Leiden: Brill, 2012, f. 80.

⁴⁰ ASV, CSM, 2° S., b. 48, 11 prill 1705.

e gomuar (Boccassine)		
Mëndafsh	Pako / koli me 250 libra	6
Pambuk	Pako / koli me 250 libra	7.21
Saftjan	Pako / koli me 170 copë	16.25
Lëkurë dashi	Pako / koli me 340 copë	16.25
Fill i bardhë dhe i kuq	140 okë	60
Shafran	në ludra	30
Pambuk i tjerrur	deng me 70 okë	30
Batanije dalmate të mëdha	një	3
Batanije dalmate të mesme	një	2
Batanije dalmate të vogla	një	1
Pambuk	140 okë	40
Gëzof ariu	një	2
Duhan	140 okë	24
Lëkurë qengji	100 copë	40
Lëkurë kau	një	2
Vaj	520 okë	40
Serë (Pisë)	1000 libra	6
Tapet për gondola	një	
Fije të kuqe	Pako / koli prej 24 librash	
Saftjan	1000 copë	10.12

Tabela 2: Lista e tarifave të zakonshme doganore në akçe të mallrave të eksportit të 26 prillit 1710⁴¹

Malli	Sasia	Tarifa në akçe më 1710
Lesh	140 okë	24
Dyll dhe saftjan	140 okë	60
Lëkurë dashi	140 okë	30
Lëkurë bualli	për copë	4
Mëndafsh	140 okë	120
Kërmëz	140 okë	80
Kafe	140 okë	60
Mbulesa krevati me lesh të ashpër	100 copë	100
Pëlhurë Damask i verdhë	deng prej 70 okësh	35
Veshje të bardha salonike	për deng	30

⁴¹ *Po aty*, CSM, 2° S., b. 48, tarifat e mallrave të shpallura më 4 korrik 1710 dhe të miratura nga Senati më 26 prill 1710; Angelo Martini, *Manuale di metrologia, ossia misura, pesi e monete in uso attualmente e anticamente presso tutti i popoli*, Torino: Loescher, 1883, shih Durrësi, f. 202. Shifrat janë të shprehura në okë, e cila i korrespondonte shifrës prej 1.6 kg, por njëkohësisht egzistonte në Durrës edhe oka e Stambollit e barabartë me 1.28 kg.

Havjar	për fuqi	20
Fill i bardhë dhe i kuq	140 okë	60
Shafran	me ludra	30
Pambuk i tjerrur	deng prej 70 okësh	30
Batanije dalmate të mëdha	një	3
Batanije dalmate të mesme	një	2
Batanije dalmate të vogla	një	1
Pambuk i tjerrur	140 okë	40
Gëzof ariu	një	2
Duhan	140 okë	24
Lëkurë qengji	100 copë	40
Lëkurë kau	një	2
Vaj	520 okë	40
Pizë	1000 libra	6
Veshje	një	60
Mëndafsh me fije ari	15 okë	60
Mall	me arkë	30
Mall	deng i vogël	20

Tarifa doganore për leshin llogaritej sipas peshës përkatësisht me njësinë matëse të librave të mëdha për çdo deng, për dyllin me libra të vogla, ndërsa për lëkurët me një numër prej njëmijë copash.⁴²

Ekzistonte gjithashtu edhe lista e tarifave për pastrimin e mallrave (*expurgo*) për anijet që niseshin nga Durrësi dhe Shkodra, të cilave Venecia u dha mundësi deri në vitin 1710 që ashtu si karvanët tregtarë, të cilët niseshin nga Shqipëria dhe zona të tjera të Ballkanit, t'i karantinonin mallrat në lazaretet e porteve dalmate të Kastelnovos (Herceg Novi), Raguzës dhe Splitit përpara se të arrinin në Venecie.⁴³ Në fakt, kjo ishte një lloj përkujdesje për të parandaluar epideminë e murtajës. Për shembull, në lazaretin e Kastelnovos, tregtarët dhe disa mallra si saftjani, dylli dhe duhani mbaheshin në karantinë për 21 ditë, ndërsa mallra si leshi dhe mëndafshi qëndronin më gjatë deri në 40 ditë dhe laheshin në ujin e lumit pranë të cilit ishte ndërtuar lazareti⁴⁴. Ishte kjo arsyeja përse

⁴² A. Martini, *Manuale di metrologia...*, f. 818-19. Në Venecia një libër e madhe ishte e barabartë me 0.4769 kg, ndërsa një libër e vogël ishte e barabartë me 0.300 kg. Të shprehura ndryshe, 1000 libra të mëdha veneciane ishin të barabarta me 476.9 kg, kurse 100 libra të vogla ishin të barabarta me 30 kg.

⁴³ ASV, CSM, 1. S., b. 661, 20 shtator 1706; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit*, dok. nr. 128, 12 korrik 1702, f. 232-233; G. Candiani, "Sanità e controllo mercantile nelle Bocche di Cattaro...", f. 39.

⁴⁴ G. Candiani, "Sanità e controllo mercantile nelle Bocche di Cattaro...", f. 50.

epidemia e murtajës që ra në Durrës në vitet 1701-2⁴⁵ dhe 1705,⁴⁶ nuk ndikoi aq shumë mbi marrëdhëniet tregtare.

Për fat të keq nuk kemi të dhëna për tregtinë e karvanëve tregtarë shqiptarë që kalonin në këtë periudhë në portet dalmate, të cilat do të shërbenin për të plotësuar panoramën e tregtisë me Venecian.

Taksat doganore në total gjatë shek. XVII-XVIII për tregtinë me Venecian varionin nga 4%-13%.⁴⁷ Ato përfshinin përveç taksës veneciane të Cottimo-s edhe taksën e ndërmjetësimit tregtar si dhe shpenzime shtesë për siguracionin detar të mallrave, hipotekimin dhe qiramarrjen e anijes dhe magazinimin e mallrave në portin e Durrësit dhe në Doganën e Detit në Venecia etj.

Mallrat duhet të paguanin gjithashtu edhe taksën doganore të Perandorisë Osmane që ishte 3% dhe më pas tregtarëve u lëshohej një *teskere* ose dëftesë, e cila ishte e vlefshme si mandat pagesë për t'u paraqitur në të gjitha doganat osmane përfshirë edhe ato përgjatë rrugëve tokësore.⁴⁸

Në raport me fuqitë e tjera tregtare, Venecia kishte kontrollin e Adriatikut dhe i detyronte zakonisht anijet e huaja tregtare të paguanin taksën e Gjirit, siç e quante asokohe këtë det, e cila përdorej për mirëmbajtjen e anijeve të Kapitenit të Gjirit (Adriatikut), autoritet i lartë venecian me seli në Kotorr që kishte funksionin e rojës bregdetare në Adriatik dhe i mbronte anijet nga inkursionet korsare.⁴⁹ Ishte një taksë vjetore prej 120 dukatësh për anijet e mëdha dhe 48 dukatësh për anijet e vogla. Këtë taksë e paguanin në dekadën e parë të shek. XVIII edhe anijet perastine të portit të Durrësit megjithëse shtetas veecianë.

Në fakt, Venecia ishte një faktor stabiliteti në Adriatik. Kështu, gjatë luftës për Fronin e Spanjës (1701-1713), që u mbyll me Paqen e Utrehtit (1713), e cila kishte vënë përballë disa fuqi europiane dhe në radhë të parë Francën me Austrinë pas vdekjes së Mbretit spanjoll Carlos II, që i përkiste dinastisë së Habsburgëve, duke i hapur rrugën ardhjes në fron të

⁴⁵ ASV, CSM, 1° S., b. 661, 18 prill 1701; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, dok. nr. 23, 18 prill 1701, f. 67; *po aty*, dok. nr. 45, 6 shtator 1702, f. 98-99.

⁴⁶ *Po aty*, CSM, 1° S., b. 661, 29 korrik 1705; *po aty*, dok. nr. 63, 29 korrik 1705, f. 124.

⁴⁷ Corey Tazzara, *The Free Port of Livorno and the Transformation of the Mediterranean World (1574-1790)*, Oxford: Oxford University Press, 2017, f. 236.

⁴⁸ *Letra të Konsujve venedikas të Durrësit...*, "Hyrje", f. 14.

⁴⁹ ASV, CSM, 2° S., b. 61, Il libro dei Ristretti.

Mbretit Filipe IV, themelues i dinastisë franceze të Burbonëve,* Venecia mbajti një qëndrim neutral, gjë që do të ndikonte në mbarëvajtjen e tregtisë. Autoritetet veneciane i bënë të ditur palëve në konflikt se do të kujdeseshin për të siguruar ruajtjen e Adriatikut si zonë neutrale dhe nuk do të lejonin futjen e anijeve luftarake të flotës së tyre. Pozicioni i saj i paanshëm ishte një mburojë për anijet tregtare të të gjitha palëve.⁵⁰ Kështu, francezët i propozuan konsullit venecian të Durrësit Giorgio Cumano, ngritjen e flamurit venecian mbi një anije të re tregtare franceze në portin e Durrësit, e cila ishte destinuar për tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Francës dhe ia besuan drejtimin e saj një kapiteni perastin, në mënyrë që të mbrohej nga sulmet e anijeve të palëve kundërshtarë kryesisht austriake. Në fakt, konsulli venecian i Durrësit sipas udhëzimeve të Pesë të Urtëve për Tregtinë u tregua i gatshëm dhe ua lejoi atyre një gjë të tillë.⁵¹

Prania e pesë doganave në Durrës, Kavajë dhe në grykëderdhjen e lumenjve Ishëm, Erzen dhe Shkumbin, ku gjendej Kalaja e Bashtovës,⁵² nga të cilat e para zë vendin kryesor, është një dëshmi e qartë e drejtimit të fluksit të mallrave.⁵³ Në shek. XVII, në mungesë të një pazari në Durrës, pazari më i afërt ishte ai i Kavajës, që kishte 200 dyqane dhe mbahej të premtën dhe të dielën.⁵⁴

Mallrat kryesorë që tregtoheshin nga porti i Durrësit drejt Venecias ishin sipas rëndësisë: dylli, lëkurët, leshi dhe duhani dhe në sasi më të vogla: vaji, druri, pambuku, mëndafshi, gëzofi i kafshëve të egra, kërmëza e valanidhit, fara e lirit, havjari, pastërmaja etj.

* Pikërisht, më 15 mars 1702, Anglia, Provincat e Bashkuara të Holandës dhe Austria i shpallën luftë Francës.

⁵⁰ Mario Nani Mocenigo, *Storia della marina veneziana da Lepanto alla caduta della Repubblica*, Ministero della Marina, Roma: Tipografia Litografia dell'Ufficio di Gabinetto, 1935, f. 314-315.

⁵¹ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 12 korrik 1702; *Letra të konsujve venedikas ...*, dok. nr. 43, 12 korrik 1702, f. 96.

⁵² Evliya Çelebi, *Shqipëria para tre shekujsh (1662-1772)* (botimi i parë Shkodër: 1930), përktheu Sali Vuçiterni, Tiranë: Besa, 2000, f. 79. Të ardhurat doganore të Bashtovës ishin nën jurisdiksionin e doganierit të Durrësit.

⁵³ ASV, CSM, 1. S., b. 661, 20 shtator 1706; *po aty*, dok. nr. 127, 20 shtator 1706, f. 231.

⁵⁴ "III Visitationsbericht Marco Scura..." , f. 113; E. Çelebi, *Shqipëria para tre shekujsh ...*, f. 83.

Në grykëderdhjen e lumit Ishëm pranë Kepit të Rodonit, shkëmbeheshin kryesisht druri që shërbente për ndërtimin e galeave veneciane, franceze dhe raguzane si dhe gruri, misri, orizi etj.⁵⁵

Mallrat kryesorë të importit venecian ishin veshjet prej leshi të quajtura londrinë si dhe pëlhurat e veshjet prej pambuku, liri dhe mëndafshi, bereta ose feste, qelqi i Muranos (rruaza, pasqyra), hekurishtet që përfshinin produktet prej çeliku e hekuri të Breshias, artikujt prej metali (tunxh, bakër), qirinjtë, gajtanët e artë, kancelaria (letër shkrimi) etj.⁵⁶

Mallrat e eksportit tregtoheshin ose këmbeshin në Durrës me mallra importi si pëlhurat veneciane ose sera (pisa), e cila arrinte nga Vlora dhe vlerësohej me çmimin 12 realë për 1000 libra.⁵⁷

Në periudhën 1684-1692, 16.625 veshje prej leshi londrinë ndër 21.192 të tilla që përbënin 78% të tyre ishin destinuar për tregun ballkanik.⁵⁸ Kriza e prodhimeve prej leshi me të cilën u përball industria veneciane në gjysmën e dytë të shek. XVII, vazhdoi deri në fund të shekullit kur nga 10.000 veshje prej leshi ato u reduktuan në 2.000 për një treg që përfshinte Shqipërinë, Bosnjën dhe Maqedoninë.⁵⁹

Për sa i përket statistikës së mallrave të ardhura nga Shqipëria në Venecie në vitin 1680, sasia e leshit shqiptar ishte 4.266 dengje, ndërsa ajo e duhanit ishte 526 pako (koli) dhe e mëndafshit nga Vlora 456 pako (koli).⁶⁰

Me gjithë të dhënat e pakta që kemi për tregtinë e Durrësit në shek. XVII, në periudhën maj 1684 - prill 1685, pas shpërthimit të luftës së Moresë, tregtia e Durrësit me Venecian vazhdonte dhe numëronte përkatësisht 6.134 dengje dhe pako (koli) në vitin 1685 me një taksë doganore prej 5.527,14 dukatësh, vit në të cilin shifra ishte më e lartë krahasuar në të njëjtën periudhë me 5.974 dengje dhe pako të tregtisë së Raguzës me Venecian, ndërsa në periudhën maj 1685 - prill 1686 numri i

⁵⁵ G. Candiani, "Sanità e controllo mercantile alle Boche di Cattaro...", f. 34.

⁵⁶ Giovanni Antonio Morana, *Saggio delli commerciali rapporti dei veneziani colle ottomane scale di Durazzo ed Albania e con quelle d'Aleppo, Siria e Palestina*, Venezia: F. Andreolo, 1816, f. 36-37.

⁵⁷ *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, dok. nr. 14, 27 nëntor 1700, f. 57; G. A. Morana, *Saggio delli commerciali rapporti...*, f. 48. Konsulli i fundit venecian i Durrësit Morana flet për një "commutazione in denaro, o in altre merci".

⁵⁸ Domenico Sella, *Commerci e industrie a Venezia nel secolo XVII*, Istituto per la collaborazione culturale, Venezia, Roma: 1961, f. 64.

⁵⁹ *Ibidem*.

⁶⁰ D. Sella, *Commerci e industrie...*, f. 115.

tyre ishte 9.576 dengje dhe pako me një taksë doganore prej 9.018,23 dukatësh dhe së fundi në periudhën maj 1686 - prill 1687 numëroheshin 9.067 dengje dhe pako me një taksë doganore prej 7.927,10 dukatësh.⁶¹

Nga numri në total i dengjeve dhe pakove mund të krijojmë tabelën e tre produkteve kryesore: dyllit, lëkurëve dhe leshit:

Tabela 3: *Tregtia e dyllit nga Durrësi në Venecia në periudhën 1684-87*⁶²

Viti	Lloji i mallit	Nr. i pakove ose kolive (collì)	Pesha në libra (libbre)	Të ardhurat doganore në dukatë
1684-5	Dyll	3.176	788.310	2.627,17
1685-6	Dyll	4.418	913.879	3.796,16
1686-7	Dyll	2.179	553.149	1.843,20

Tabela 4: *Tregtia e lëkurëve nga Durrësi në Venecia në periudhën 1684-87*⁶³

Viti	Lloji i mallit	Nr. i dengjeve	Nr. i lëkurëve	Të ardhurat doganore në dukatë
1684-5	Lëkurë (saftjan dhe shollë)	440	98.575	1.022,72
1685-6	Lëkurë (qengji, saftjan, kanavacë e gomuar)	532	95.596	1.029,03
1686-7	Lëkurë (qengji, keci, saftjan, shollë, qosele, kanavacë e gomuar)	592	101.421	2.149,59

Tabela 5: *Tregtia e leshit nga Durrësi në Venecia në periudhën 1684-87*⁶⁴

Viti	Lloji i mallit	Nr. i dengjeve	Pesha në libra (libbre)	Të ardhurat doganore në dukatë
1684-5	Lesh	2.386	347.206	771,14
1685-6	Lesh	4.355	620.147	1.378,3
1686-7	Lesh	5.829	862.667	1.917,1

⁶¹ ASV, CSM, 2° S., b. 350, nr. 396-397; Alvin Saraçi, "Tregtia e Durrësit dhe e Raguzës me Venecien pas shpërthimit të luftës së Moresë (1684-1699)", në *Studime historike*, nr. 1-2, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2016, f. 62-65.

⁶² ASV, CSM, 2° S., b. 350, nr. 396-397; A. Saraçi, "Tregtia e Durrësit dhe e Raguzës me Venecien...", f. 62-65.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *Po aty*.

Me sa vërehet nga tabela e mësipërme, në trevjeçarit 1684-87, tregtia e leshit dhe e lëkurëve ishte në rritje, ndërsa ajo e dyllit në zbritje.

Po të kemi parasysh shifrat e përgjithshme të tregtisë së dyllit të Venecias me Lindjen, e cila përfshinte tregtinë me Perandorinë Osmane dhe Ballkanin në veçanti ku bënin pjesë Durrësi, Raguzë, principatat rumune, Izmiri (Smirne), Stambolli, Morea etj., mund t'i përjasim ato me shifrat e tregtisë së dyllit të Durrësit me Venecian gjatë trevjeçarit 1685-1687 si vijon:⁶⁵

Tabela 6: *Tregtia e dyllit të Lindjes dhe Durrësit me Venecian në periudhën 1685-87*⁶⁶

Viti	Lloji i mallit	Nr. i pakove ose kolive (<i>colli</i>)	Nr. i pakove ose kolive (<i>colli</i>)	Diferenca e pakove
1685	Dyll	11.341	3.176	8.165
1686	Dyll	7.161	4.418	2.743
1687	Dyll	6.312	2.179	4.133

Në dekadën 1684-1694, taksa doganore e mallrave të eksportuara dhe të importuara nga dhe drejt portit të Durrësit me Venecian arrinte në 69.764 zekinë (dukatë) venecianë, e cila përbënte 72% të taksës doganore të përgjithshme të mallrave që arrinin nga të gjitha portet e Adriatikut⁶⁷. Tregtia ndërmjet Durrësit dhe Raguzës me Venecian vazhdoi deri më 1694, për t'u ndërprerë më pas për një pesëvjeçar deri në Traktatin e Karlovicit.⁶⁸ Megjithatë, edhe pas vitit 1694, shkëmbimet tregtare me Venecian vazhduan me anë të konsullatave franceze dhe holandeze në

⁶⁵ C. Luca, "L'importazione delle merci Levantine...", f. 346.

⁶⁶ ASV, CSM, 2° s., b. 18, reg.III/2, 4 maj 1693.

⁶⁷ Cristian Luca, "Venetian merchants in the Lower Danube Area and the role in the development of the international trade exchanges in the Seventeenth Century", në *The Czech Historical Review / Český Časopishistorický*, Ročník 109/2011, nr. 2, Založen: 1895, f. 326.

⁶⁸ Pietro Garzoni, *Istoria della Repubblica di Venezia in tempo della sacra lega contra Maometto IV, e tre suoi successori, Gran Sultani de' Turchi di Piter Garzoni Senatore*, vol. 1, Venezia: Giovanni Manfrè, 1707, f. 511-512. Më 1694, tregtarët venecianë u dëbuan nga Perandoria Osmane dhe nuk iu lejua as anijeve veneciane transporti i mallrave nga Shqipëria "nè meno sotto la scorta di bandiere amiche".

Durrës, por kjo ndikoi në rritjen e taksës doganore në 20% të vlerës së mallit.⁶⁹

Përsa i përket fillimit të shek. XVIII, statistikat dëshmojnë se tregtia e Durrësit me Venecian ishte shumë e begatë. Në periudhën katërvjeçare maj 1700 – prill 1704, porti i Durrësit eksportonte drejt Venecias rreth 45.943 dengje dhe pako me një taksë doganore prej 50.961,1 dukatësh.⁷⁰ Në tabelën e mëposhtme jepet numri i dengjeve përkatësisht sipas viteve, të cilat fillojnë nga maji dhe përfshijnë periudhën deri në prill të vitit në vijim si dhe sasia e mallrave e shprehur në libra:

Tabela 7: *Tabelë përmbledhëse e tregtisë së Durrësit me Venecian në katërvjeçarin maj 1700 – prill 1704*⁷¹

Viti	Nr. i dengjeve	Sasia në libra	Taksa doganore në dukatë
Maj 1700 – prill 1701	9.903	1.614.200	
Maj 1701 – prill 1702	10.360	1.254.322	
1 maj 1702 – prill 1703	17.176	1.193.600	
1 maj 1703 – prill 1704	14.504	1.033.818	
Për katërvjeçarin në tërësi:	45.943	5.095.940	50.961,1

Siç duket tregtia prej Durrësit me Venecian arrin kulmin në vitin 1702-1703. Po t'i referohemi numrit të dengjeve dhe pakove sipas tabelës së mësipërme, tregtia e Durrësit me Venecian në katërvjeçarin e parë të shek. XVIII i kishte zëvendësuar më së miri portet dalmate të një shekulli më parë dhe kryesisht rrugën tregtare transite të Splitit (*la scala di Spalato*) që ishte hapur më 1592, nga ku arrinin në Venecia një numër mesatar vjetor prej 11.000 dengjesh dhe pakosh para kësaj date, ndërsa në periudhën 1592-1596 numri i tyre ishte 16.460 dengje në vit, në vitin 1619 numëroheshin 17.520 dengje dhe më 1626 numri i tyre arrin kulmin me 25.000 dengje.⁷²

⁶⁹ ASV, CSM, 2° s., b. 27/bis, 14 mars 1699.

⁷⁰ *Po aty*, CSM, 2° S., b. 28, 4° parte, 24 shtator 1704; C. Luca, “L’importazione di merci levantine...”, f. 348.

⁷¹ ASV, CSM, 2° S., b. 28, 4° Parte, 24 shtator 1704.

⁷² Renzo Paci, *La «Scala» di Spalato e il commercio veneziano nei Balcani fra Cinque e Seicento*, Venezia: Deputazione di Storia Patria, 1971, f. 93-95; Domenico Sella, “L’economia”, *Storia di Venezia, Dal Rinascimento al Barocco, il Seicento*, ed. Alberto Tenenti e Ugo Tucci, Istituto dell’Enciclopedia italiana “Giovanni Treccani”,

Përveç sasisë së dengjeve të mallrave në total për katërvjeçarit 1701-1704, mund të bazohemi edhe në tabelat e veçanta të dengjeve të dy mallrave më të rëndësishëm në portin e Durrësit, dyllit dhe dy llojeve të lëkurëve (saftjan dhe lëkurë dashi).

Tabela 8: *Tregtia e dyllit të Durrësit me Venecian në katërvjeçarit maj 1700 – prill 1704*⁷³

Viti	Dyll me pako (koli)
1 maj 1700 – prill 1701	4.225
1 maj 1701 – prill 1702	2.594
1 maj 1702 – prill 1703	2.253
1 maj 1703 – prill 1704	1.403
Në total 1700-1704	10.475

Lidhur me tregtinë veneciane të dyllit, deri në fillimin e shek. XVIII, arrinin në Durrës rreth 4000 dengje me dyllë ose e llogaritur me 270 libra të vogla për deng, janë përafërsisht baras me arrinte në 1.080.000 libra.⁷⁴ Por në vitet e para sipas konsullit të Venecias në Durrës, numri i dengjeve pothuajse u përgjysmua për shkak të konkurrencës holandeze.

Tabela 9: *Tregtisë së saftjanit dhe lëkurëve të dashit nga Durrësi në Venecie në katërvjeçarit maj 1700 – prill 1704*⁷⁵

Viti	Saftjan dhe lëkurë dashi me dengje
1 maj 1700 – prill 1701	475
1 maj 1701 – prill 1702	463
1 maj 1702 – prill 1703	510
1 maj 1703 – prill 1704	431
Në total 1700-1704	1.879

vol. 5, Roma: 1994, f. 651-711; *po ai, Commerci e industrie...*, f. 55. Madje, Domenico Sella e shpreh numrin e 25.000 dengjeve në 4.000 ton.

⁷³ ASV, CSM, 2° S., b. 28, 4° parte, 24 shtator 1704; C. Luca, “L’importazione di merci levantine...”, f. 346-347.

⁷⁴ ASV, CSM, 1° S., b. 661, 17 giugno 1706; *Letra të konsujve venedikas...*, dok. nr. 114, 17 giugno 1706.

⁷⁵ ASV, CSM, 2° S., b. 28, 4° parte, 24 shtator 1704; C. Luca, “L’importazione di merci levantine...”, f. 346-347.

Tabela 10: *Tregtia e leshit dhe e mallrave të tjerë nga Durrësi në Venecie në katërvjeçarin maj 1700 – prill 1704*⁷⁶

Viti	Lesh dhe mallra të tjerë me dengje
1 maj 1700 – prill 1701	5.203
1 maj 1701 – prill 1702	7.303
1 maj 1702 – prill 1703	14.413
1 maj 1703 – prill 1704	12.670
Në total: 1700-1704	39.589

Ekzistojnë edhe policat konsullore të ngarkesave të anijeve për periudhën 1700-1704, të cilat janë të mangëta dhe në disa raste të paplotësuara siç duhet, sepse përmbajnë vetëm numrin e dengjeve, por nuk japin sasinë në libra të mallrave. Prandaj, të dhënat janë të pamjaftueshme dhe do të plotësohen me dokumente të tjerë. Kësisoj, për vitin 1700 në dokumentacionin konsullor ruhen dy policë-ngarkesa dhe flitet për një anije tjetër që ishte nisur më 10 shkurt 1700.⁷⁷

Dy anije të tjera të mbytura, njëra nga moti i keq dhe tjetra nga sulmet korsare mund të llogariten si humbje që pësoi tregtia si për sasinë e mallrave ashtu dhe për të ardhurat konsullore dhe doganore.

Në vitin 1703, policë-ngarkesa e anijes e hartuar nga konsulli i ri Giorgio Emmanuele Cumano përmban për herë të parë edhe një përmbledhje të numrit të dengjeve dhe pakove dhe të sasisë në libra, megjithëse ato mungojnë për disa mallra.⁷⁸

Me ardhjen e konsullit Pietro Rosa në vitin 1705, vërehet një plotësim më i saktë i policave të ngarkesave të anijeve, të cilat janë të shumta në numër e të plota me pasqyrat përmbledhëse të numrit të dengjeve dhe pakove, sasinë në libra të të gjitha mallrave të ngarkuara, të cilat na japin mundësi që në bazë të shifrave të hartojmë statistika tregtare. Në periudhën 1705-1733, konsulli Pietro Rosa tentoi ta ripërtërinte tregtinë, megjithëse ishte në rrugën e rënies.⁷⁹ Një hap tjetër që do t'i jepte hov tregtisë ishte propozimi që konsulli Rosa u bëri Pesë të

⁷⁶ *Po aty*.

⁷⁷ ASV, CSM, 1° S, b. 661, 27 shkurt 1700; 3 nëntor 1700; (policë-ngarkesa) dokument i padatur.

⁷⁸ *Po aty*, CSM, 1° S, b. 661, 18 tetor 1703.

⁷⁹ Rossana D'Alberton Vitale, "La scala di Durazzo negli anni del console Rosa (1705-1733)", në *Studi veneziani*, vol. XXXIV, Istituti editoriali e poligrafici internazionali, Pisa, Roma: 1997, f. 208.

Urtëve për hapjen e nënkonsullatës së Shkodrës, e cila e filloi aktivitetin e saj në tetor 1706. Ai zgjodhi me miratimin e Pesë të Urtëve Pjetër Engjëllin në postin e nënkonsullit të Shkodrës.⁸⁰ Më parë, tregtia e Shkodrës me Venecian administrohej nga dy nëpunës ose agjentë konsullorë, të dërguar nga konsullata veneciane e Durrësit.⁸¹ Gjithashtu, konsulli i Venecias në Durrës propozoi edhe hapjen e një nënkonsullate veneciane në Vlorë, projekt që nuk u realizua.⁸²

Venecias iu desh gjithashtu të përballonte monedhën e re të sapoprerë raguzane, e cila preferohej më tepër në doganat e Perandorisë Osmane, dhe i kishte rritur fitimet e tregtarëve me rreth 20%, prandaj e lehtësonte kalimin e mallrave kryesisht të dyllit në Raguzë.⁸³ Nga ana tjetër, nxjerrja në qarkullim e saj, e kishte e dobësuar atë, sepse ajo peshonte 1/3 herë më pak se e mëparshmja, duke sjellë si rezultat humbjen e besimit tek tregtarët, të cilët ishin të kujdesshëm që të mos akumulonin shuma të mëdha në monedhë raguzane për të mos patur humbje.

Sipas një statistike të konsullatës veneciane të Durrësit, brenda shtatë muajve e gjysmë në periudhën 15 korrik 1705 deri në shkurt 1706 ishin nisur nga porti i Durrësit tetë anije veneciane me rreth 9.200 dengje të vegjël dhe pako, të cilat transportonin 1.251.304 libra lesh, 165.623 libra dyllë dhe 82.257 copë saftjan dhe lëkurë dashi.⁸⁴ Leshi i Shqipërisë së ardhur në Venecie në periudhën 1705-1706 ishte sa dyfishi i leshit të ardhur nga Morea dhe Stambolli.⁸⁵ Kjo për faktin se ishte i cilësisë së lartë dhe kishte një çmim të ulët.

⁸⁰ A. Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës me Venecien...*, f. 195-197.

⁸¹ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 6 shtator 1702; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, dok. nr. 45, 6 shtator 1702, f. 99.

⁸² *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, "Hyrje", f. 13.

⁸³ *Po aty*, dok. nr. 65, 29 korrik 1705, f. 124.

⁸⁴ ASV, CSM, 1° S., b. 661, 24 shkurt 1706; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, tabelë e bashkangjitur, dok. nr. 98, 24 shkurt 1706, f. 180.

⁸⁵ Bruce William McGowan, *Economic life in the Ottoman Europe, taxation, trade and the struggle for land, 1600-1800*, Cambridge University Press, Paris, Maison des Sciences de l'homme, New York, Cambridge: 1981, f. 31.

Tabela 11: Tabela statistikore e hartuar nga konsulli venecian i Durrësit për mallrat e anijeve të ngarkuara nga porti i Durrësit për në Venecie në periudhën 15 korrik 1705 - shkurt 1706 (për vitin 1705)

Emri i anijes	Lesh (nr. i dengjeve të vegjël)	Lesh (pesha në libra)	Dyllë (nr. i pakove)	Dyllë (pesha në libra)	Saftjan, lëkurë dashi e damaski -ne (nr i dengjeve)	Saftjan, lëkurë dashi e damaskine (nr. i copëve)	Numri në total i dengjeve dhe pakove me mall të ngarkuara nga anijet
Fregata e madhe “Anna Maria”	427	75.059	204	55.924	184	44.110	1.012
Fregata e madhe “San Michele Arcangelo”	941	166.215					976
Fregata e madhe “Madonna del Rosario e Sant’ Iseppo”	994	177.059	88	24.891	55	15.557	1.153
Fregata e madhe “Santa Giustina e San Giovanni”	1001	179.155	66	17.877	32 ½	9.225	1.149
Trabakulli “Madonna di Scarpello e San Nicolò”	456	87.693	4	1.062			460
Petakja “San Spiridion”	1.620	293.853	2	475	23 ½	5.337	1.730 ½
Marçiliana “Madonna dei Carmeni”	563	103.139	61	16.712	20 ½	4.230	777

Fregata e madhe "Madonna dei Carmini e Sant' Antonio di Padova"	946	169.131	176	48.682	47	73.768	1.474
Shuma e të gjithë mallrave në total	6.950	1.251.304	601	165.623	361 ½	92.560	9.267 ½

Duke iu referuar statistikës së konsullatës veneciane në Durrës, po të krahasojmë tabelën e mësipërme të tregtisë së Durrësit me Venecian, në të njëjtën periudhë numri i pakove me dyllë dhe i dengjeve me lesh ishte tre herë më i lartë sesa numri i pakove dhe dengjeve të transportuara nga konsullata franceze e Durrësit me anije franceze dhe ulqinaqe drejt Raguzës dhe Ankonës.⁸⁶

Tabela 12: *Tregtia franceze me Durrësin për periudhën 15 korrik 1705 – shkurt 1706*

Lesh (nr. i dengjeve)	Dyllë (nr. i pakove)	Saftjan (nr. i dengjeve)	Saftjan, lëkurë bualli dhe viçi (nr. i copëve)
2538	1951/2	17 ½	3283

Sigurisht, edhe ligji i ri për tregtinë i Senatit venecian të 6 gushtit 1705, ndikoi pozitivisht edhe kundrejt konkurrencës franceze. Por në vitin 1705, konsujt francezë dhe holandezë vazhdonin të kërkonin sipas një ligji të vjetër taksën e baxhit prej 5% nga anijet veneciane, me gjithë beratin e Sulltanit të vitit 1700 për heqjen e taksës, por me ndërhyrjen e bailit venecian në Stamboll Ascanio Giustinian, doli një dekret i dytë në gusht 1705 që i lironte anijet veneciane nga kjo taksë.⁸⁷

Kemi krijuar gjithashtu një statistikë duke llogaritur sipas përmbledhjeve të policave të ngarkesave dhe datës së nisjes të të gjitha anijeve për vitin 1705, numrin e dengjeve, sasinë në libra ku shifrat pothuajse përputhen me tabelën e hartuar nga konsulli venecian. Megjithatë, për tregtinë e leshit shifrës së mësipërme i shtohen edhe 240 dengje të papeshuara, të cilave nuk u është shprehur sasia në libra.

⁸⁶ *Po aty.*

⁸⁷ *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, dok. nr. 69, gusht 1705, f. 138.

Tabela 13: *Statistikë sipas policave të ngarkesave për mallrat kryesorë: dyllin, lëkurët dhe leshin për vitin 1705*

Emri i anijes / data e nisjes	Dyllë (nr. i pakove)	Dyllë (pesha në libra)	Lëkurë (nr. i dengjeve)	Lëkurë (nr. i copëve)	Lesh (nr. i dengjeve)	Lesh (pesha në libra)
<i>Anna Maria</i> 21 korrik 1705	206	56.024	183	45.118	427	74.057
<i>San Michele Arcangelo</i> 8 gusht 1705			5	895	869 72	147.164 6.939 okë ⁸⁸
<i>Madonna del Rosario</i> 13 gusht 1705	94	25.593	61	18.159	1.014	177.040
<i>Madonna dello Scarpello e San Niccolò</i> 8 shtator 1705	4	1.062			458	87.693
<i>Santa Giustina e San Giovanni</i> 11 shtator 1705	66	17.877	35 ½	9.761	1.001	179.175
<i>San Spiridion</i> 25 shtator 1705	2	475	47 ½	9.108	1.620	293.853
<i>Madonna del Carmine</i> 18 tetor 1705	61	16.712	25	4.330	563 70	103.139
Shuma e të gjithë mallrave në total	433	117.743	357	87.371	6.094	1.091.172

⁸⁸ Sipas tabelës statistikore të konsullit, ato janë baras me 29.051 libra.

Dalja e ligjit të ri të tarifave doganore dhe të qirave të anijeve, që u miratua nga Senati më 6 gusht 1705 pati si qëllim rritjen e tregtisë, prandaj ishte në favor të tregtarëve, ndërsa kapitenët e anijeve nuk mbetën të kënaqur.⁸⁹ Shkak për këtë ishin tarifat e ulëta të qiramarrjes së anijeve nga ana e tregtarëve për transportin e mallrave. Në rastin e lëkurëve në portin e Durrësit, tarifa prej 10,15 dukatësh për njëmijë lëkurë saftjan me një peshë prej 2500 librash ishte ulur në 7½ dukatë.⁹⁰ Kjo solli si rezultat një rënie të tregtisë së lëkurëve për shkak se kapitenët e anijeve refuzonin transportin e tyre, pasi duhet të merrnin përsipër shpenzimet për lëkurët e dëmtuara gjatë udhëtimit.⁹¹ Në fakt, ata i kërkuan konsullit që tarifa e qiradhënies së anijeve të ishte edhe në Durrës e njëjtë sipas ligjit me të gjitha vendet e Mesdheut Lindor, sepse përndryshe ishte për ta e papërballueshme.⁹²

Madje, pati dhe ndonjë kontrast si në rastin kur kapiteni i një anije ngarkoi me ngurrim 16 ½ dengje me lëkurë të ardhura nga Elbasani pas ndërhyrjes së konsullit venecian, sepse dëshironte që policia e ngarkesës të përmbante shprehjen *dice essere*, që do të thoshte se ekuipazhi nuk mbante përgjegjësi për cilësinë e mallit⁹³. Tregtarët menduan si zgjidhje që të paguanin tarifën e plotë prej 10,12 dukatësh për saftjanin në mënyrë që kapitenët të pranonin firmosjen e policave të ngarkesave të anijeve sipas sasisë dhe cilësisë, pra duke marrë përsipër ruajtjen e cilësisë së mallit deri në Venecia.⁹⁴

Nga ana tjetër, ligji i ri stimuloi tregtinë e leshit, e cila arriti kulmin në vitin 1705, sepse ky produkt preferohej më tepër nga kapitenët e anijeve për faktin se kishte pothuajse të njëjtën tarifë me lëkurët prej 7 ½ dukatësh për 1000 libra, por ngarkesat me lesh peshonin më pak. Megjithatë, kapitenët e anijeve nuk ishin dakord as me tarifën e leshit, prandaj u kërkuan Pesë të Urtëve me ndërmjetësimin e konsullit që ta

⁸⁹ *Po aty*, dok. nr. 77, 19 shtator 1705.

⁹⁰ *ASV, CSM*, 1. S., b. 29. Tarifat e qirave të anijeve sipas dekretit të Senatit, 8 gusht 1705.

⁹¹ *Letra të konsujve venedikas të Durrësit...*, dok. nr. 80, 27 shtator 1705, f. 157.

⁹² *Po aty*, dok. nr. 78, 19 shtator 1705, f. 151. "*Le nostre divotissime istanze, accioche la varia ci sia unificata all'uso del Levante, non potendo più stare al praticato*".

⁹³ *Po aty*, dok. nr. 80, 27 shtator 1705, f. 157.

⁹⁴ *Po aty*, dok. nr. 91, 31 dhjetor 1705, f. 174.

rrisnin qiranë edhe për këtë produkt sipas marrëveshjes me tregtarët për kontratat e qiramarrjes të vitit 1701 në 8,5 dukatë.⁹⁵

Në bazë të policë-ngarkesave të anijeve, kemi krijuar një tabelë edhe për vitin 1706 për ngarkesat e anijeve sipas datës së nisjes nga porti i Durrësit në Venecia, ku për tre produktet kryesore është dhënë numri i dengjeve për leshin e lëkurët dhe i pakove për dyllin si dhe është shprehur sasia e tyre në libra.

Tabela 14: *Statistikë sipas policave të ngarkesave të anijeve për mallrat kryesorë: dyllin, lëkurët dhe leshin për vitin 1706*

Emri i anijes / Data e nisjes	Dyllë (nr. i pakove)	Dyllë (pesha në libra)	Lëkurë (nr. i dengjeve)	Lëkurë (nr. i copëve)	Lesh (nr. i dengjeve)	Lesh (pesha në libra)	Numri në total i dengjeve dhe pakove me mall të ngarkuara nga anijet
<i>Madonna del Rosario e San Vincenzo</i> 11 prill 1706	1.291	354.445	88	19.031	109	21.185	1.809
<i>Tre Magi</i> 26 qershor 1706	575	157.551	65	14.427	96	16.662	903
<i>Anna Maria</i> 4 gusht 1706	188	50.663	71	18.255	914	156.500	1.174
<i>Santa Giustina e San Giovanni</i> 19 gusht 1706	10	2.735	27	5.568	1.155	193.387	1.191
<i>Spirito Santo</i> 25	26	6.996	22	4.659	814	140.438	888

⁹⁵ *Po aty*, dok. nr. 31, 1 nëntor 1701, f. 77-78; *po aty*, dok. nr. 62, 21 korrik 1705, f. 120-121.

gusht 1706							
<i>Madonna dei Carmini</i> 12 tetor 1706			6	1.256	519 150	98.147	674
<i>Madonna di Marina</i> 12 tetor 1706	45	12.104	29	6.518	1.174	215.161	1.264
Shuma e të gjithë mallrave në total	2.135	584.494	308	129.225	4.931	841.480	7.903

Në fakt, siç duket nga tabela, falë efekteve të ligjit dhe tarifave të reja doganore për tregtinë në vitin 1706 vërehet një pesëfishim i tregtisë së dyllit dhe rritje e asaj të lëkurëve me 33.665 copë krahasuar me vitin 1705, ndërsa tregtia e leshit pësoi një rënie pas normalizimit të transportit të ngarkesave me lëkurë. Sigurisht, po të përquaset sasia e mallrave të mësipërme me mallrat e ardhura nga Durrësi në doganën e detit në Venecie, vërehet se për disa nga mallrat ka ndryshime, sepse sasia e tyre në Venecie është më e vogël se ajo që paraqitet nga konsulli venecian në Durrës. Kjo ndoshta për shkak se mallrat ishin të dëmtuara sepse gjatë udhëtimit të dytë pas pastrimit të mallrave (*espurgo*) në lazaretet e Splitit, Herzeg Novi-t dhe Raguzës, një pjesë e tyre ndryshonin drejtim dhe kalonin kryesisht në portin e Ankonës ose në portet e tjerë të Adriatikut.

Tabela 15: *Tre produktet kryesore të tregtisë së portit të Durrësit në doganën e detit në Venecie në dyvjeçarin 1705-1706*⁹⁶

Viti	1705		1706	
	Sasia në libra	Dukatë	Sasia në libra	Dukatë
Leshi i Shqipërisë	1.008.936	2.390,10	620.576	621,13
Saftjan dhe lëkurë dashi	127.827	1.278,12	62.175	621,3
Dylli	393.082	4.734	536.738	6.496,9
Veshje salonike	5.302	636,28	1.418	159,19

⁹⁶ ASV, CSM, 2° S, b. 48, 11 shkurt 1714.

Taksa në dukatë për 4 produktet	9.038,22	7.898,52
--	-----------------	-----------------

Në dyvjeçarin 1707-8, kishte nisur fenomeni i largimit të tregtarëve të Voskopojës nga Durrësi drejt vendeve të tjera të Europës Qendrore, gjë që do të vazhdonte dhe do të bëhej më e theksuar pas Traktatit të Pasarovicit (Požarevac, 21 korrik 1718). Po t'i referohemi sasisë në libra, tregtia e Durrësit me Venecien në këtë periudhë pati një rënie.

Tabela 16: *Katër produktet kryesore të tregtisë së portit të Durrësit në dyvjeçarin 1707-1708⁹⁷*


Viti	1707		1708	
Malli	Sasia në libra	Dukatë	Sasia në libra	Dukatë
Leshi i Shqipërisë	830.192	1.845,14	952.139	2.094,5
Saftjan dhe lëkurë dashi	43.348	433,16	39.656	396,16
Dylli	225.400	2.727,12	370.334	4.531,17
Taksa në dukatë për 4 produktet	5.005,42		7.021,83	

Si përfundim, hapja e konsullatës veneciane ndikoi në një mirorganizim të tregtisë në portin e Durrësit, duke i dhënë atij përparësi si udhëkryq për kalimin e mallrave drejt Venecies. Në trevjeçarin 1684-7, tregtia e Durrësit me Venecien u rrit nga 6.000 në 9.500 dengje, ndërsa në katërvjeçarin 1701-3, numri i dengjeve arriti kulmin nga 10.000 në 17.000 dengje dhe pati një rënie të lehtë në vitin 1704 në 14.500 dengje, ndërsa në vitin 1705 numri i tyre zbriti në 9.000 dengje dhe në vitin 1706 në 8.000 dengje.


⁹⁷ *Po aty.*

Shtojcë e grafikëve përmbledhës të tregtisë së tre produkteve kryesore në periudhën 1685-1708 e shprehur në dengje, pako dhe libra


Grafiku a




Grafiku b




Grafiku c




Grafiku d




Grafiku e




Grafiku f




Grafiku g



Grafiku h



Grafiku i



S u m m a r y

THE TRADE RELATIONS BETWEEN ALBANIA AND VENICE THROUGH THE PORT OF DURAZZO DURING THE LAST PERIOD OF THE XVII CENTURY AND THE FIRST DECADE OF THE XVIII CENTURY

The trade relations between Albania and Venice in XVII and XVIII centuries are of interest for the economic history as by means of quantitative statistics of the three main goods: wax, leather and wool, we can establish the trade fluctuations of the flow of goods that passed through the port of Durazzo to Venice. In the second half of the XVII century, the economic growth of Albania was stable and increased in the first decade of the XVIII century. As trade relations between Albania and Venice flourished, the Venetians decided in 1671 the opening of a consulate in Durazzo. Durazzo became the most important transit port in the Adriatic for the trade relations with Venice after the decline in 1674 of the port of Split. Thus, in the period 1684-7, trade between Durazzo and Venice increased from 6.000 to 9.500 *colli* (packages) and during the three years 1700-3, their number went up from 10.000 to 17.000 *colli*, slightly decreasing in 1704 in 14.500 *colli* and even more in 1705 in 9.500 *colli*, while in 1706 were registered 8.000 *colli*.